



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 6/17
Prishtinë, më 31.10.2017, ora 9:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku dhe Enverë Hoti.

Munguan: Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Blerim Kuqi, Mytaherë Haskuka dhe Fikrim Damka.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Lumir Abdixhiku, kryetar, konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017**

Kumir Abdixhiku, kryetar- Komisionet tjera të përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga komisioni ynë, dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje. Procedura kërkon që ne të votojmë raportin final me amendamente dhe ta procedojmë për shqyrtim të dytë në Kuvend.

Pas sqarimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Miratohet raporti final për Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017, me amendamentet e propozuara, si vijon:

Amendamenti 1

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Infrastrukturës**”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim:

- 1.1. Nënprogrami “Projektet e bashkëfinancimit me kuvendet komunale ”, me kod 42000, në tabelën 3.2, emërtimi i projektit “Asfaltimi i rrugës Rogov-Has-Prizren”, me kod 15371, ndryshohet në emërtimin “Asfaltimi i rrugës Rogovë- Has-Gjakovë”.

Amendamenti 2

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Infrastrukturës**”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim:

- 1.1. Në nënprogramin “Ndërtimi i autostradave”, me kod 42200, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve kapitale, shuma prej 180,786,415 €, ndryshohet në shumën 182,486,415€.

- 1.2. Nënprogrami “Ndërtimi i autostradave”, me kod 42200, në tabelën 3.2, në Projektin “Rruga Nacionale Prishtinë-Gjilan-Konçul”, me kod 15090, shuma prej 150,000 €, ndryshohet në shumën 1.850.000€.

Amendamenti 3

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Financave**”, me kod organizativ 201, bëhen ndryshimet si në vijim:

- 1.1. Në nënprogramin “Administrata Tatimore” me kod 11600, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve kapitale, shuma prej 1,520,000 €, ndryshohet në shumën prej 520,000 €.

- 1.2. Nënprogramin “Administrata Tatimore”, me kod 11600, në tabelën 3.2”, në kategorinë shpenzime kapitale, në projektin me kod 12005 “Sistemi i ri bazë i tatimeve”, shuma prej 1,200,000 €, ndryshohet në shumën prej 200,000 €.

Amendamenti 4

1. Në organizatën buxhetore “**Zyra e Kryeministrit**”, me kod organizativ 104, bëhen ndryshimet si në vijim:

- 1.1. Në nënprogramin “Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës”, me kod 40800, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve kapitale, shuma prej 6,343,286 €, ndryshohet në shumën 5,643,286€.

- 1.2. Nënprogrami “Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës”, me kod 40800, në tabelën 3.2, kategoria e shpenzimeve kapitale, në projektin me kod 13337 “Kofinancimi – faza e I e projektit për ndërtimin e fabrikës së riciklimit (IPA), shuma prej 2,321,178 €, ndryshohet në shumën 1,621,178 €.

Amendamenti 5

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**”, me kod organizativ 209, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin “Pensionet për Invalidët e Luftës”, me kod 00300, kategoria subvencione dhe transfere, në tabelën 3.1, shuma prej 37,850,000 €, ndryshohet në shumën 38,050,000 €.

Amendamenti 6

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Financave**”, me kod organizativ 201, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin “Thesari”, me kod 11200, kategoria e subvencioneve dhe transfereve, në tabelën 3.1, shuma prej 422,042 €, ndryshohet në shumën 462,042 €.

Amendamenti 7

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë**”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Nënprogramin “Instituti i Historisë-Prishtinë”, me kod 97100, kategoria e shpenzimeve komunale, në tabelën 3.1, shuma prej 0 €, ndryshohet në shumën 823.39 €.
 - 1.2. Në nënprogramin “Administrata Qendrore”, me kod 11308, kategoria e shpenzimeve komunale, në tabelën 3.1, shuma prej 59,770 €, ndryshohet në shumën 58,946.61 €.

Amendamenti 8

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Zhvillimit Ekonomik**”, me kod organizativ 213, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Nënprogrami “Infrakos”, me kod 27700, në tabelën 3.2, në projektin me kod 30217 “Furnizimi me pjesë rezervë të infrastrukturës”, shuma prej 30,217 €, ndryshohet në shumën 67,440 €.
 - 1.2. Nënprogrami “Infrakos”, me kod 27700, në tabelën 3.1, kategoria e subvencioneve dhe transfereve, shuma prej 877,035 €, ndryshohet në shumën 839,812 €, burimi i financimit nga grantet qeveritare.

Amendamenti 9

1. Në organizatën buxhetore “**Këshilli Prokurorial i Kosovës**”, me kod organizativ 250, bëhen ndryshimet si në vijim:

- 1.1. Në nënprogramin “Prokurorët dhe Administrata” me kod 33500, kategoria e mallrave dhe shërbimeve, në tabelën 3.1, shuma prej 1,557,370 €, ndryshohet në shumën 1,607,370 €.

Amendamenti 10

1. Në organizatën buxhetore “**Zyra e Kryeministrit**”, me kod organizativ 104, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin “Kabineti i Kryeministrit”, me kod 10700, kategoria e mallrave dhe shërbimeve, në tabelën 3.1, shuma prej 1,214,317 €, ndryshohet në shumën 1,263,357 €.

Amendamenti 11

1. Në organizatën buxhetore “**Shpenzimet e Paparashikuara**”, me kod organizativ 232, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 13100, kategoria e Rezervës, në tabelën 3.1, shuma prej 3,209,589 €, ndryshohet në shumën 2,870,549 €.

Amendamenti 12

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Financave**”, me kod organizativ 201, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në tabelën 3.1, shtohet nënprogrami “Kontigjenca e Sigurimeve Shëndetësore”, me kod 28200, kategoria e pagave dhe mëditjeve dhe shuma prej 11,000,000 €.

Amendamenti 13

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Infrastrukturës**”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin “Ndërtimi i autostradave”, me kod 42200, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve kapitale, shuma prej 182,486,415 €, ndryshohet në shumën 171,486,415 €.
 - 1.2. Në nënprogramin “Ndërtimi i autostradave”, me kod 42200, në tabelën 3.2, në kategorinë shpenzime kapitale, në projektin me kod 13256 “Autostrada Prishtinë-Hani i Elezit (R6)”, shuma prej 180,636,415 €, ndryshohet në shumën 169,636,415 €.

Amendamenti 14

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**”, me kod organizativ 222, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në nënprogramin “Administrata Qendrore”, me kod 11322, në tabelën 3.1, numri i punëtorëve prej 3 pozitive, ndryshohet në 8 pozita.
 - 1.2. Në nënprogramin “Zyra e Ministrit”, me kod 11422, në tabelën 3.1, numri i punëtorëve prej 9 pozitive, ndryshohet në 13 pozita.

Amendamenti 15, nga deputeti Avdullah Hoti, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Projekti me kodin 14691-Fabrika e ujërave të zeza në Pejë, të kthehet siç ka qenë i parashikuar me Ligjin për Buxhetin e vitit 2017, me shumën e parashikuar prej 380.000€ .

Amendamenti 16, nga deputeti Avdullah Hoti, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Projekti me kodin 15360 – Ndërtimi i objektit të Fakultetit Ekonomik dhe Juridik, të kthehet siç ka qenë i parashikuar me Ligjin për Buxhetin e vitit 2017, me shumën e parashikuar: për vitin 2017 – 50.000€; për vitin 2018 1.000, 000€, dhe për vitin 2019 1.300.000 €.

Amendamenti 17

1. Në organizatën buxhetore “**Ministria e Financave**”, me kod organizativ 201, bëhen ndryshimet si në vijim:

Në nënprogramin “Administrata Qendrore”, me kod 11301, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve kapitale, shuma prej 870,000 €, ndryshohet në shumën 440,000 €.

- 1.1. Nënprogrami “Administrata Qendrore”, me kod 11301, në tabelën 3.2, në kategorinë shpenzime kapitale, në projektin me kod 13616 “Zhvillimi i sistemit për deponimin e të dhënave (datawarehouse), integrimi i sistemeve të MF-së”, shuma prej 800,000 €, ndryshohet në shumën 440,000 €.

- 1.3. Nënprogrami “Administrata Qendrore”, me kod 11301, në tabelën 3.2”, në kategorinë shpenzime kapitale, në projektin me kod 11286 “Ndërtimi i objektit të ATK – Doganë në Prishtinë”, shuma prej 70,000 €, ndryshohet në 0 (zero) €.

Amendamenti 18

Harmonizimi i tabelave të buxhetit, bëhet në pajtim me amendamentet e miratuara në pjesën tabelore të Projektligjit nr.06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-125, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 9:15

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

**Kryetari Komisionit,
Lumir Abdixhiku**
